

## EKSPONATET DHE MUZEU – PASURI, HISTORI, TRASHËGIMI

Bekim XHEMILI  
Muzeu Etnologjik i Kosovës  
Prishtinë

Punim studimor

**Përmbledhje e shkurtër:** Në këtë punim do të trajtojmë një pjesë të vogël të historisë dhe të kontributit të Muzeut të Kosovës, si dhe mbledhjen e koleksionit muzeal të fushës së etnologjisë dhe pasurimin me ekspozate të reja. Muzeu i Kosovës përkundër vështirësive, rrethanave dhe sfidave që ka kaluar gjatë veprimtarisë së tij, që nga themelimi në vitin 1949, ka arritur që t'i japë shumë fushës së kulturës. Duke filluar kështu me hulumtimet e para të mirëfillta në Kosovë në fushën e arkeologjisë, pastaj të etnologjisë, të natyrës, të historisë e të tjera. Ka arritur ta zbulojë thesarin arkeologjik dhe me dhjetëra lokalitete arkeologjike të Kosovës. Një numër i madh i ekspozateve arkeologjike, etnologjike, historike, të natyrës, numizmatikës, pastaj dokumente, fotografi, janë mbledhur dhe sjellë në muze nga punëtorët e tij, duke krijuar kështu koleksionet e para, të cilat tashmë janë të shumta, të periudhave dhe të fushave të ndryshme. Janë hapur institucione të reja kulturore në kuadër të Muzeut të Kosovës. Fondin e etnologjisë e përbëjnë disa mijëra ekspozate, që prezantojnë kryesisht periudhën e shekujve XVIII-XX, dhe të cilat mund të klasifikohet sipas periudhave historike, përbërjes lëndore, përkatësive etnokulturore dhe strukturave të ndryshme sociale, ekonomike dhe shoqërore. Vëmendja për këtë punim do të jetë te pjesa e historisë gojore, e kujtesës, e trashëgimisë familjare si dhe e vlerave kulturore, artistike, shpirtërore të ekspozateve të mbledhura dhe të dhuruara nga qytetarët gjatë viteve

të fundit. Janë gjithsej gjashtë bashkëbisedime të subjekteve të ndryshme, që janë përshkruar sipas eksponateve, të cilat i kanë dhuruar. Sfidë mbetet shkaktërimi i qindra mijëra objekteve dhe shtëpive familjare bashkë me eksponate, gjatë luftës së fundit në Kosovë, mungesa e hulumtimeve kërkimore-mbledhëse dhe mosndarja e buxhetit për blerje të koleksioneve private. Gjithashtu zhvillimet e shpejta ekonomike, shoqërore dhe teknologjike dhe mënyra e jetesës në kohët moderne, duke detyruar familjet që të mos përdorin më gjëra të vjetra të trashëguara nga paraardhësit e tyre.

**Fjalët çelësa:** Kosovë, muzeu, eksponate, trashëgimi, etnologji, pasuri, histori, motive

Themelimi i institucioneve kulturore në Kosovë filloi tek pas Luftës së Dytë Botërore, pra më 1945. Në këtë kontekst, edhe themelimi i muzeve nuk bëri përjashtime. Vetëm pas vitit 1945 filluan të bëhen përpjekje për hapjen e muzeve të parë, si institucione të rëndësishme kulturore. Muzeu i parë që është themeluar në Kosovë është “Muzeu i Kosovës” më 1949 në Prishtinë, kurse është hapur në vitin 1951.<sup>1</sup> Deri në hapjen e “Muzeu të Kosovës”, pra në vitin 1949, ekspeditat kërkimore-shkencore-mbledhëse, realizoheshin në Kosovë kryesisht nga punonjësit e institucioneve kulturore të vendeve të ish-Jugosllavisë, veçanërisht, ata të Beogradit, të cilët në ato raste kishin mbledhur një numër të madh të eksponateve, të arkeologjisë dhe të etnologjisë<sup>2</sup>. Themelimi i Muzeut të Kosovës, përkundër të gjitha rrethanave politike-ekonomike dhe kulturore që mbretëronin në atë kohë, vlerësohet si një nga arritjet kryesore kulturore të Kosovës së asaj periudhe. Kjo për faktin se, për herë të parë, po bëhej hapja e një institucioni profesional që do të ishte kompetent dhe do të merrej me mbledhjen e thesareve të kulturës materiale dhe shpirtërore të popullit të Kosovës, si dhe do të bëhej studimi dhe ekspozimi i fondit të mbledhur. Duke filluar kështu me hulumtimet e para të mirëfillta në Kosovë në fushën e arkeologjisë, pastaj të etnologjisë, natyrës, historisë etj. Punonjësit e këtij muzeu kanë arritur të zbulojnë me dhjetëra lokalitete arkeologjike të Kosovës dhe thesarin arkeologjik në to. Po ashtu, nga etnologët e muzeut janë hulumtuar deri diku një pjesë e krahinave të Kosovës. Një numër i madh i eksponateve arkeologjike, etno-

<sup>1</sup> Vasilije Kozarac, *Glasnik muzeja Kosova - Buletini i Muzeut të Kosovës*, (Prishtinë: 1956).

<sup>2</sup>Po aty.

logjike, historike, të natyrës, numizmatikës, pastaj dokumente, fotografi, janë mbledhur dhe sjellë në muze nga punëtorët e tij, duke krijuar kështu koleksionet e para, të cilat tashmë janë të shumta, të periudhave dhe fushave të ndryshme.<sup>3</sup>

### **Mbulimi i hapësirës kosovare me eksponate muzeale**

“Muzeu i Kosovës” në fillim kishte një koleksion të vogël dhe modest të etnografisë, pastaj dalëngadalë filloi mbledhja sistematike e eksponateve në terren. Vitet 1950 shënojnë fillimin e hulumtimeve, gjurmimeve dhe ekspeditave të “Muzeut të Kosovës”, në lokalitetet arkeologjike të kohës së neolitit, të bronzit, e të metaleve, pastaj në lokalitetet e kohës romake dhe njëkohësisht bëhet edhe mbledhja e materialit etnologjik, historik, natyror në terren. Në vitin 1957 koleksionet e “Muzeut të Kosovës” kishin materiale muzeore që arrinin numrin mbi 8500, prej tyre 2000 etnologjike. Për një periudhë pune e veprimtarie njëzetvjeçare, deri në vitin 1972, Muzeu mblodhi rreth 33000 eksponate muzeore, nga të cilat koleksioni etnologjik 4735<sup>4</sup>. Në sektorin e Etnologjisë për 50 vjet punë, 1949-1999 edhe pse janë mbledhur disa mijëra eksponate (stoli, tekstile, metali, druri, poçeri etj.) nga rajonet e ndryshme të Kosovës, hulumtimet deri në atë kohë kanë qenë të pjesërishme. Etnologu i njohur shqiptar Kadri Halimi, i cili ka qenë edhe shef i sektorit të etnologjisë nga viti 1955 deri 1961, ka bërë hulumtime në treva të ndryshme të Kosovës si dhe ka bërë mbledhjen e eksponateve. Fatkeqësisht, pushteti i atëherëshëm komunist ia ndaloi punën në muze dhe më 1961 e burgosi, së bashku me një grup shqiptarësh, që nuk pajtoheshin me sjelljet e pushtetit ndaj shqiptarëve. Ai u dënua me 7 vjet e 6 muaj burgim, që i vuajti në burgje të ndryshme të ish-Jugosllavisë. Pas daljes nga burgu, pushteti totalitar nuk e lejoi që të punësohet sërish në “Muzeun e Kosovës” dhe t’i kthehet kulturës dhe shkencës.<sup>5</sup> Proceset gjyqësore politike nëpër të cilat kaluan anëtarët e organizatave dhe grupeve ilegale, të zhvilluara në çdo

<sup>3</sup> Bekim Xhemilit ‘Mbulimi i hapësirës kosovare me objekte prezentative muzeale’, *Albanologji 4*(Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2014), f. 283-288.

<sup>4</sup> Tefik Morina, ‘Rruga e zhvillimit dhe perspektiva e muzeve në Kosovë’, *Buletini i Muzeut të Kosoves*, nr. XII,(Prishtinë, 1973), f. 249.

<sup>5</sup> Drita Statovci, ‘Portreti i një veterani të shkencës shqiptare: Kadri Halimit’, *Trajtime dhe studime etnologjike*, , (Prishtinë:Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2000), f. 314, 315, 317.

qark gjyqësor të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi nga viti 1945-1990 (45 vjet) kundër shqiptarëve janë shqiptuar hiç më pak se 66.672 vjet e 7 muaj burg ose 666 shekuj, 72 vjet e 7 muaj burg. Krahasuar me numrin e gjithëmbarshtëm të popullsisë në Jugosllavi, shqiptarët merrnin pjesë më 12% kurse në numrin e të dënuarve politikë me mbi 90%. Të dënuarit politikë shqiptarë vetëm në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë deri më 1990 ishin 1681 veta, me 11.935 vjet burg. Mirëpo dënimet dhe proceset e montuara politike, të cilat vazhduan me dekada, nuk mundën ta shuanin idealin e popullit për liri dhe bashkim kombëtar”.<sup>6</sup>

Nëse bëjmë një analizë për praninë dhe numrin e personeli shqiptar në sektorin e etnologjisë, Kadri Halimi 1955-61, Nahire Surroi, 1960-70<sup>7</sup>, Ramadan Ibrahimimi në fillim të viteve 1970-1978<sup>8</sup> dhe Sazana Kullashi nga viti 1983 deri në vitin 1999, pra gjithsej 4 punëtorë shqiptarë, atëherë mund të paramendohet se sa kanë pasur hapësirë dhe mundësi reale për hulumtime dhe mbledhje të thesarit të etnokulturës shqiptare në Kosovë. Puna e bërë nga etnologët shqiptarë dhe punëtorët profesionalë në Muzeun e Kosovës, nëpër ekspeditat hulumtuese, si dhe në vjeljen e materialeve etnologjike dhe të tjera në terren duhet vlerësuar, por nëse do të ishin punësuar edhe disa etnologë shqiptarë dhe kuadro të tjera, dhe të punohej në mënyrë sistematike-profesionale, pa ndikime të çfarëdo natyre, në hulumtimin e të gjitha krahinave të Kosovës, me siguri që numri i eksponateve të mbledhura nga terreni do të ishte më i madh sesa ai që është mbledhur deri tani. Përfaqësimi më i madh i kuadrit profesional shqiptar në Muzeun e Kosovës vërehet tek pas vitit 1974, kur edhe Kosova fiton autonominë në kuadër të Republikës Federative të Jugosllavisë. Në vitet 1970 punësohen disa kuadro profesionale, si: arkeologë, etnologë, historianë. Por përkundër këtij fakti, numri që i vogël dhe nuk ishte i lehtë punësimi i shqiptarëve me kualifikim të lartë. Këtu përjashtim bënin ata me shkollim fillor dhe të mesëm. Në sektorin e historisë puna që është bërë nga themelimi i muzeut të Kosovës e deri në përfundim të luftës 1999, ka qenë e ndarë në disa periudha, por ato më kryesoret ishin: periudha e luftës nacional çlirimtare, lëvizja punëtoare dhe ndërtimi i sistemit socialist. Sektori i historisë ka vepruar në kuadër të

<sup>6</sup> Sabile Keçmezi - Basha, *Të burgosurit politikë shqiptarë në Kosovë 1945-1990* (Prishtinë: Logos A 2009).

<sup>7</sup> Nga intervista me Kemajl Lucin, arkeolog në Muzeun e Kosovës, prill 2011.

<sup>8</sup> Nga intervista me Ramadan Ibrahimimin, punonjës i Institutit Albanologjik të Prishtinës, maj 2011.

kornizave të sistemit ideologjik-komunist dhe nuk ka mundur të veprojë jashtë tyre, duke bërë që temat e vetme të trajtuara të ishin ekskluzivisht në baza ideologjike dhe jo të bazuara në arritjet shkencore dhe metodologjike, siç veprojnë në muzetë e ndryshëm në botë. Në këto rrethana ishte ndaluar dhe e pamundur prezantimi i historisë së mirëfilltë të popullit shqiptar. Derisa, historia serbe favorizohej dhe ekzagjerohej, ajo shqiptare ishte e anashkaluar, e keqinterpretuar dhe e paprezantuar. Kështu, një numër i madh i temave, periudhave, personaliteteve të historisë shqiptare, nuk kanë mundur të trajtohen, sepse ato ishin të ndaluara dhe të anatemuara.<sup>9</sup> Vlen të theksojmë që nuk kanë munguar edhe censurat, në forma të ndryshme, që të mos prezantoheshin etnokultura, identiteti dhe historia e popullit shqiptar në Kosovë. Censura e pushtetit të atëhershëm është reflektuar edhe në ekspozitat e përgatitura nga punëtorët shqiptarë të Muzeut të Kosovës. Çdo gjë që ishte kombëtare dhe që duhej të ekspozohej, kalonte nëpër censurë, me arsyetimin që nxiste nacionalizëm tek popullata. Në këtë kontekst, do të tregojmë një rast që i ka ndodhur studiuesit Riza Sadikut (historian në Muzeun e Kosovës) gjatë vitet 1978-1979 dhe i cili gjatë intervistës shprehet kështu: “Është interesante që në vitet 1978-79 kam qenë në Prizren për me mbledhë materiale, dhe kam gjetë materiale ku është mbajtur manifestimi i çlirimit të Prizrenit, një fotografi shumë e bukur, ishte flamuri shqiptar dhe flamuri i Jugosllavisë në vitin 1944, dhe në manifestim ishin shqiptarët nga Zhuri me kapuç të bardhë (plisa). Ajo fotografi ishte markante dhe unë e mora, pastaj kur patëm një ekspozitë e zmadhuam dhe e prezantuam, pasi edhe ne donim t'i prezantonim simbolet kombëtare, flamurin, kapuçin e bardhë të vitit 1944. Besoni që atë fotografi vetëm një herë na kanë lanë me prezantim. Na e hoqi Komiteti Komunal i Prishtinës, për arsye se thoshin që është nacionaliste.”<sup>10</sup>

Politika serbe e viteve `90 të shek. XX, ishte politikë e persekutimit, e përndjekjes, e burgosjes, e dhunës, e vrasjes, e shkeljes së të drejtave të shqiptarëve dhe e presionit për braktisjen e vendit. Po ashtu, duke imponuar gjuhën serbe, përmes serbizimit të rajonit, ndërrimit të emrave shqiptarë të rrugëve, pastaj duke ndaluar botimet në gjuhën shqipe, si dhe shkatërrimin e institucioneve kulturore shqiptare. Kështu, u mbyll Insti-

<sup>9</sup> Nga intervista me Mr. Mehmet Gjoshi, historian në “Muzeun e Kosovës”, mars, 2011

<sup>10</sup> Nga intervista me Dr. Riza Sadiku, historian në “Muzeun e Kosovës”, prill, 2011, Prishtinë.

tuti Albanologjik i Prishtinës, duke i dëbuar stafin akademik nga zyrat, sallat e leximit në Bibliotekën Universitare Kombëtare u shndërruan në shkolla ortodokse serbe, si dhe u dërguan shumë materiale bibliotekare në Serbi, ndërsa në Muzeun e Lidhjes së Prizrenit, u morën materialet, kurse muzeu u shndërrua në një motel për refugjatët serbë nga Kroacia<sup>11</sup>. Në vitet '90, për qëllime të caktuara politike, autoritetet serbe ia ndërronjë emrin, nga "Muzeu i Kosovës" në "Muzeun e Prishtinës". Qëllimi i tyre ishte që, nëpërmjet ndërrimit të emrit, "Muzeun e Kosovës" ta shndërronjë në muze rajonal, duke bërë një degradim dhe ulje të vlerës së këtij muze. Deri në qershor 1999, numri i punëtorëve të "Muzeut të Kosovës" ka qenë 38, prej tyre 10 shqiptarë, 27 serbë dhe 1 romë. Një pjesë e punëtorëve kanë qenë të pakualifikuar dhe janë pranuar me vetëdëshirën e drejtorit të atëhershëm, duke lënë anash kështu punëtorët e kualifikuar, të cilët në atë kohë ishin shumë të nevojshëm për veprimtarinë e rregullt të muzeut. Se sa ishte i politizuar "Muzeu i Kosovës" tregon edhe fakti që deri në hyrjen e forcave të KFOR-it në Kosovë, në qershor të vitit 1999, muzeun e ka udhëhequr drejtori i emëruar drejtpërsëdrejti nga Ministria për Kulturë e Serbisë, dhe kurrë nuk është marrë parasysh mendimi i punëtorëve të muzeut dhe i strukturave të atëhershme kosovare. Drejtori ka punuar me direktivat e Ministrisë dhe nuk ka vepëruar konform rrethanave dhe nevojave të muzeut.<sup>12</sup> Në vitet 1997-1999, nga "Muzeu i Kosovës" janë huazuar materialet e dy ekspozitave tematike "Thesari Arkeologjik i Kosovës" dhe "Stolitë dhe qëndisja me ar" dhe janë dërguar në Beograd. Ekspozita e parë përfshinte eksponate nga periudha e neolitit, eneolitit, pastaj të metaleve (të hekurit dhe bronzit), periudha antike dhe eksponate nga mesjeta e hershme. Ndërsa, në ekspozitën etnologjike, bënin pjesë stolitë dhe punimet e ndryshme me fije ari. Këto ekspozita janë botuar edhe në katalogë të veçantë në Beograd. Pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, punëtorët shqiptarë nuk kanë pasur qasje në Muzeun e Kosovës dhe nuk u është lejuar hyrja. Sikur të mos mjaftonte kjo, punëtorët serbë të muzeut, pa paralajmërim morën një numër të konsiderueshëm të materialit etnologjik të muzeut dhe e dërguan në "Muzeun Etnografik të Beogradit". Në librat regjistruar të "Muzeut të Kosovës" janë të evidentuara 676 eksponate arkeologjike dhe 571 eksponate etnologjike, pra gjithsej 1247 eksponate, të cilat gjenden dhe mbahen pa të drejtë në Beograd. "Hyjnesha në fron" është i

<sup>11</sup> Noel Malcolm, *Kosova -një histori e shkurtër* (Prishtinë: Koha, 2011), f. 439.

<sup>12</sup> Të dhëna nga "Muzeu i Kosovës", prill 2011.

vetmi ekspонат që i është kthyer muzeut në vitin 2002<sup>13</sup>. Ndërsa nuk dihet dhe nuk janë i evidentuar numri i eksponateve etnologjike të marra në vitin 1999 në prag të përfundimit të luftës në Kosovë.<sup>14</sup>

Pas përfundimit të luftës dhe çlirimit të Kosovës në qershor të vitit 1999, “Muzeu i Kosovës” rifilloi punën dhe punëtorët nisën të kthehen nëpër vendet e tyre të punës. Nga viti 1999 deri në vitin 2004, gjysma e hapësirave të “Muzeut të Kosovës” ishte e zënë nga administrata e bashkimit evropian. Përkundër sfidave, ky muze nuk e ndali punën e rregullt, dhe punëtorët profesionalë të arkeologjisë, etnologjisë e të historisë rifilluan punën në hulumtimin e rajoneve të Kosovës, mbledhjen dhe sjelljen e eksponateve në muze. Janë hapur dhjetëra ekspozita të përkohshme dhe të përhershme nga fondi i arkeologjisë, historisë dhe etnologjisë, si dhe janë botuar katalogë dhe libra nga koleksionet e muzeut.

Hapja e institucioneve të reja muzeore në Kosovë është një tjetër kontribut që ka bërë “Muzeu i Kosovës” në fushën e kulturës. Në kuadër të tij janë hapur: “Muzeu Etnologjik i Kosovës”, muzeu “Shtëpia e Pavarësisë - Dr. Ibrahim Rugova”, “Parku Arkeologjik i Kosovës”. Ka bashkëpunuar me muzetë rajonale në Kosovë, në drejtim të zhvillimit të veprimtarisë muzeore, themelimit dhe hapjes së muzeve të rinj, memorialeve të luftës dhe shtëpive-muze të personaliteteve të historisë dhe kulturës sonë kombëtare. Nuk ka munguar edhe bashkëpunimi me muzetë e vendeve të rajonit dhe të disa vendeve të Evropës. “Muzeu i Kosovës”, që nga viti 2011, është pjesë e rrjetit ballkanik të muzeve dhe prezantohet në mënyrë të barabartë me të gjithë muzetë e rajonit. Në vitin 2016 “Muzeu i Kosovës” është bërë anëtar i ICOMIT – Këshillit Ndërkombëtar të Muzeve.

Mënyra moderne e jetesës, ka bërë që popullata të zëvendësojë objektet e vjetra të përdorimit shtëpiak, si: enët, orenditë, veglat dhe mjetet e punës, veshjet, shtrojat, mbulojat me ato moderne. Një pjesë e madhe e tyre janë shkatërruar gjatë luftës së fundit në Kosovë, 1998-1999, por që edhe shumë të tjera janë dëmtuar dhe zhdukur, në mungesë të vetëdijes për rëndësinë dhe vlerën që bartin ato. Në shumë krahina të Kosovës, edhe sot në shek. XXI, mund të hasim në shtëpi-objekte tradicionale shqiptare, të cilat ruajnë thesare të kulturës materiale dhe shpirtërore.

---

<sup>13</sup> Nga intervista me Çeçile Staka, dokumentariste në “Muzeun e Kosovës”, mars, 2011.

<sup>14</sup> Nga intervista me shefin e sektorit të etnologjisë në “Muzeun e Kosovës”, Mumin Zeqirin, mars 2011, Prishtinë.

tërore. Që nga viti 1999 deri më 2011, nga terreni ishin sjellë eksponate etnologjike, pothuajse të gjitha pa pagesë, falë aktivitetit punues, por edhe të vullnetit të pashoq të qytetarëve për ta ndihmuar institucionin<sup>15</sup>. Në vitin 2011, “Muzeu Etnologjik i Kosovës” ka siguruar një fond të pasur prej 230 eksponatesh, nga një koleksionues privat, të mbledhura në krahinat e Kosovës, me përbërje lëndore, si: druri, metali, tekstili, poçari dhe materiale të tjera. Fondin e etnologjisë e përbëjnë disa mijëra eksponate, që prezantojnë kryesisht periudhën e shekujve XVIII-XX, dhe të cilat mund të klasifikohet sipas periudhave historike, përbërjes lëndore, përkatësive etnokulturore dhe strukturave të ndryshme sociale, ekonomike dhe shoqërore. “Muzeu Etnologjik i Kosovës”<sup>16</sup> gjatë 16 vjetëve të funksionimit, është pasuruar me eksponate të dhuruara vullnetarisht nga qytetarët e Kosovës. Një numër jo i vogël i qytetarëve i kanë sjellë në muze eksponatet e familjes dhe të të afërmeve të tyre, ndërsa eksponatet tjera janë siguruar nga stafi profesional gjatë hulumtimeve kërkimore anembanë vendit. Ne do t’i përshkruajmë vetëm gjashtë shembuj të dhurimit të eksponateve nga qytetarët, është fjala për vitet 2020-2022.

Eksponatet e dhuruara, i takojnë periudhave të ndryshme kohore, strukturave të ndryshme sociale, ekonomike dhe shoqërore. Këto eksponate kanë histori gojore dhe rrëfime interesante personale e familjare, të trashëguara deri në ditët e sotme. Nga intervistat e realizuara janë disa arsye që i kanë shtyrë njerëzit që t’i ruajnë dhe më pas t’i dhurojnë gjërat e tyre personale, familjare, shtëpiake, si: enët, orenditë, shtrojat, mbulojat, veshjet popullore, mjetet e punës e të tjera. Nga hulumtimet dhe intervistat tona për këtë punim, kemi nxjerrë këto përgjigje në lidhje me dhurimin e eksponateve të vizitorëve:

1. Muzeu është vend ideal dhe i sigurt për ruajtjen, konservimin dhe ekspozimin e tyre,
2. Kujtesa dhe lidhja emocionale me të kaluarën,
3. Historia dhe trashëgimia familjare që eksponatet ta vazhdojnë jetën në muze,

<sup>15</sup> Nga intervista me shefin e sektorit të etnologjisë në “Muzeun e Kosovës”, Mumin Zeqirin, mars 2011, Prishtinë.

<sup>16</sup> Për më shumë rreth historisë dhe aktiviteteve të “Muzeut Etnologjik”, shih librin e studiuesit Valon Shkodra, *Muzeu Etnologjik i Prishtinës dhe funksioni i tij* (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2019).

4. Edukimi i gjeneratave të reja për të mësuar për mënyrën se si janë punuar, prodhuar, përdorur nga familjet, këto eksponate, në vende dhe kohë të ndryshme,
5. Rëndësia e artizanateve dhe ekonomisë shtëpiake,
6. Vlera të shumëfishta dhe kontribut për muzeologjinë, kulturën dhe trashëgiminë kulturore,
7. Pamundësia që t'i ruajnë në hapësirat e tyre shtëpiake, ndërrimit të vendbanimeve apo dhe ndërtimit të shtëpive të reja,
8. Mënyra e jetesës në kushte moderne, rrjedhimisht largimi i gjërave të vjetra dhe zëvendësimi me të reja,
9. Refuzimi nga familja që të vazhdojnë t'i mbajnë në shtëpi, pasi konsiderohen gjëra të vjetra që sot nuk i hyjnë në punë askujt,
10. Vendosin t'ia dhurojnë muzeut eksponateve edhe pse kanë mundësi të shitjes së tyre,
11. Njoftimi përmes rrjeteve sociale për pranimin e eksponateve nga muze.

### **Tavani**

Në Qershor të vitit 2020, familja Shasivari nga Prishtina, ka dhuruar falas tavanin mbi 100-vjeçar të shtëpisë së tyre për Muzeun Etnologjik të Kosovës. Duke vlerësuar që tavani nuk duhet të shitet, në mënyrë që publiku i gjerë të ketë qasje dhe ta shohë nga afër këtë margaritar të trashëgimisë kulturore<sup>17</sup>. Foto 1. Tavani është planifikuar të konservohet dhe të prezantohet në të ardhmen, si pjesë e ekspozitës së përhershme në njërin nga tavanet e dhomave të shtëpisë familjare të shek. XIX. Shtëpia, ku ka qenë tavani, ishte pjesë përbërëse e (lagjes Tophane) Prishtinës së vjetër. Sipas Petrit Rizës, pronari i parë i shtëpisë ka qenë Sabit Berisha, i cili në fund të viteve `50 të shek. XX, kishte shitur shtë-

<sup>17</sup> Çmontimi i tavanit të vjetër është bërë nga një shtëpi e lagjes Tophane të Prishtinës dhe bartja në muze nga punonjësit profesionalë të “Muzeut Etnologjik”, etnologët Bekim Xhemilit, Ilir Sopjanit dhe konservatorit –restauratorit Fadil Krasniqit. Gjendja e tavanit ishte emirë, për dallim nga pjesa tjetër e shtëpisë. Tavani ishte i punuar nga materiali i drurit, përveç gozhdëve nga metali. Procesi nuk ishte fare i lehtë, për shkak të pluhurit të madh dhe gozhdëve të shumta të ngulitura në pothuajse secilën pjesë të tavanit, dhe si i tillë duhej të punohej me kujdes në secilën pjesë veç e veç. Krahas tavanit janë çmontuar dhe 3 dyer nga druri të dy hamaxhikëve të dhomës, dhe afër tyre një pjesë e bukur e drurit, e cila ishte pjesë e dekorimit të dollapëve me motive florale dhe gjeometrike.

pinë (bashkë me tavanin) për të migruar në Turqi. Shtëpia asokohe ishte blerë nga Zenel Riza (1921-1987) me prejardhje nga Gjakova, i cili me profesion ishte floktar. Familja Riza vendoset në shtëpi në vitin 1960 dhe një nga arsytet pse ishte blerë shtëpia ishte dhe tavani i bukur në dhomën e katit të dytë. Dhoma (oda qytetare me mindere) ku ishte tavani, ishte shfrytëzuar nga familja kryesisht për pritjen e mysafirëve, organizimin e ahengjeve dhe ngjarjeve të ndryshme familjare dhe shoqërore<sup>18</sup>. Në vitin 1983-1984 e gjithë shtëpia rinovohet dhe pëson ndryshime, përveç tavanit që ishte ruajtur dhe mirëmbajtur mirë. Gjatë luftës së vitit 1999, familja Riza largohet nga shtëpia për të mos u kthyer më dhe vetëm 1 vit më vonë, në vitin 2000, shtëpia i shitet pronarit të ri, familjes së Sokol Shasivarit nga fshati Barilevë e Prishtinës. Edhe kjo familje, sikurse dy të parat, vazhdoi traditën e ruajtjes dhe kujdesjes për tavanin.<sup>19</sup> Në bazë të të dhënave dhe intervistat, besohet që tavani është i vjetër mbi 100 vjet<sup>20</sup>. Mendohet se është punuar nga duart e arta të mjeshtërve dibranë, të cilët kanë qenë të njohur jo vetëm në trojet shqiptare, por dhe më gjerë, si zejtarë dhe drugdhendës të shquar. Është karakteristike mënyra e punimit të tavanit, kryesisht punëdore me brisk, gdhendjes pjesë - pjesë, e gjitha nga druri, me detaje dhe finesa të imëta, me kornizën shumëkëndëshe, mbajtëset dhe anësoret në të katra anët në formë të trekëndëshave. Motivet gjeometrike dhe florale të kombinuara në mes vete, pjesë të holla të dekorimeve në formë të shkronjës S, dhe rozeta e veçantë tetëkëndëshe në qendër të tavanit, duke formësuar një lloj mozaiku nga druri.

<sup>18</sup> Nga intervista me z. Petrit Riza, e realizuar më 12.6.2020, Prishtinë. Zenel Riza ishte i martuar me Magbule Zherka Riza, me të cilën kishin 4 fëmijë: 1 vajzë (Bisere) dhe 3 djem (Mentor, Namik dhe Petrit).

<sup>19</sup> Nga intervista me Sokol Shasivarin 12.06.2020, Prishtinë. Familja Shasivari nga Barileva, me kryefamiljar Rrahimin dhe bashkëshorten Bahtijen, janë familje e madhe me 11 fëmijë, 5 vajza dhe 6 djem, më i vogli Sokoli. Familja Shasivari (djali Blerimi) do të jetonte vetëm 2-3 muaj në të, për ta lëshuar me qira shtëpinë qiraxhinjve të ndryshëm deri në shkurt të vitit 2020.

<sup>20</sup> Tavani kishte këto dimensione: gjatësia 4.58cm - gjerësia 4.35cm, ndërsa kishte 23 rende nga druri me gjithsej 34 pjesë.



Foto 1. Çmontimi i tavanit



Foto 2. Pamja dekoruese e tavanit.

## Paja

Nezafete Karaxha-Çitaku, gjatë viteve 2020-2021 ka dhuruar vullnetarisht pajën e saj, të përbërë prej 20 eksponateve, për “Muzeun Etnologjik të Kosovës”, foto 3. Familja e saj është me prejardhje nga Gjakova, por e shpërngulur në Mitrovicë në vitin 1951<sup>21</sup>. Krahas profesionit si mësuese, Nezafetja ishte e apasionuar pas gjërave të vjetra, etnokul-

<sup>21</sup> Intervista me Nezafete Karaxha-Çitakun, nëntor 2020, Prishtinë. E lindur në Mitrovicë më 1951, me profesion ka qenë mësuese, tash në pension, jeton në Prishtinë.

turës dhe trashëgimisë kulturore, duke arritur ta ruaj pajën dhe eksponatet e vjetra të trashëguara nga familja dhe disa të tjera që i kishte mbledhur në vende dhe kohë të ndryshme. Gjatë intervistës, ajo tregon për kohën e kaluar, për punimin dhe përgatitjen e pajës, mënyrën e ruajtjes së eksponateve, por njëkohësisht shpreh gëzimin për dhurimin e pajës muzeut, si dëshirë e kahmotshme, duke u ndier e lehtësuar që tani e tutje institucioni do të merret me ruajtjen, konservimin dhe ekspozimin e tij në ambientet e muzeut, dhe duke mundësuar që gjeneratat e reja, e ato që do vijnë, do të mësojnë për një pjesë të historisë së familjes së saj<sup>22</sup>.



Foto 3. Paja e nuses, kujtim për të kaluarën.

Ekspонатet e dhuruara janë të vjetra nga 40 deri në 80 vjet: mitan - pjesë e veshjes tradicionale me dimi të Gjakovës<sup>23</sup>. Jaka e mitanit e gjitha e dekoruar me fije ari, si dhe mëngët me motive florale (lule) dhe gjeometrike. Mitani ka qenë pjesë e pajës së nënës së Nezafetes, Nerxhivanes, të dhuruar nga ana e familjes së burrit të saj, me rastin e martesës në vitin 1947. Mitanin e ka trashëguar Nezafetja dhe e ka ruajtur deri në vitin 2020, ku tani ia dhuron muzeut<sup>24</sup>. Pjesët e tjera të pajës kanë qenë edhe eksponatet si: jastëk - ngjyrë të kaltër, të dyja anët janë dekoruar me ari dhe tel, në formë të vazove me lule. Bohçe ngjyrë të bardhë e de-

<sup>22</sup> Po aty.

<sup>23</sup> Gjakova ishte dhe ende është e njohur për punimin e veshjeve tradicionale brenda ekonomive shtëpiake dhe dyqaneve në çarshinë e vjetër të qytetit.

<sup>24</sup> Në intervistë, Nezafetja shprehet e lumtur që përmes mitanit dhe muzeut, emri dhe kujtimi i nënës së saj do të jetojnë më gjatë.

koruar me fije ari, pëlhurë e thjeshtë, është përdorur për syneti, si pjesë e dekorit. Jaka e dekoruar me fije ari, me motive gjeometrike. Ka qenë pjesë e veshjes me dimi. Pështjellak - ngjyrë të kuqe me vija të kaltra, dhe disa dekore të vogla (ngjyrat: e verdhë, e zezë, e bardhë) me motive gjeometrike. Çorapë nga leshi, të dekoruar me ngjyra të llojllojshme, të ndarë në 7 pjesë, me motive gjeometrike.<sup>25</sup> Çorapë nga leshi, ngjyrë të bardhë, të dekoruar me motive gjeometrike, te pjesa e gishtërinjve me ngjyra të kuqe, të zezë, të gjelbër, të kaltër dhe ngjyrë rozë<sup>26</sup>. Bohçe të bardha të dekoruara me fije ari – të punuara me porosi në Gjakovë. Jastëk të bardhë dhe të kuq të dekoruara me fije të arit – plish. (Gjakova ka pasur fabrikë për punimin e tekstileve nga plishi – kadife). Foto.4. Shorte – këmisha të dekoruara në jakë dhe në mëngë. Dimi (kumash) të papërdorura. Pëlhurë për t'ia mbuluar sytë gjatë fjetjes fëmijës – të dekoruara me lule. Çorapë nga leshi me ngjyrë të bardhë, të dekoruar me motive gjeometrike te pjesa e gishtërinjve me ngjyra të kuqe dhe të kaltra. Çorapët janë nga rrethina e Gjakovë. Bohçe nga Pallqishiti i Tetovës (Maqedonia e Veriut), të dhuruara Nezafetes, nga zonja Misini nga Tetova, e cila ishte mikpritëse e Nezafetes si refugjate, gjatë luftës së vitit 1999 në Kosovë.



Foto 4. Jastëk i kuq i dekoruar me fije të arit.

<sup>25</sup> Çorapët i janë dhuruar Nezafetes nga halla e burrit, e cila ishte nga Llausha e Llapit

<sup>26</sup> Të dhuruara Nezafetes nga nëna e Dinit (kolegut) nga Rahovecit në vitin 1985. Nezafetjaia kishte dhënë fustanin e nusërisë si huazim gruas së Dini për dasmë, pasi nuk kishin mundësi ta blinin vetë. Si shenjë respekti, nëna e Dinit ia kishte dhuruar Nezafetes një palë çorapë.

## Jani

Historia interesante e janit më shumë se 65-vjeçar, që fillon në Kumanovë, vazhdon në Luginën e Preshevës dhe përfundon në Prishtinë, duke zënë vend në dhomën e shtëpisë së shek. XVIII të “Muzeun Etnologjik të Kosovës”. Në mars të vitit 2021, Selviye Sylejmani nga Prishtina<sup>27</sup>, ia ka dhuruar janin (1956) e familjes së saj muzeut. Foto 5. Jani ishte punuar nga Shefije (Abazi) Ramadani<sup>28</sup> (nëna e Selviye Sylejmanit) diku rreth vitit 1956 në fshatin Vaksincë të Kumanovës. Kohëzgjatja e punimit të janit ishte 20 ditë, dhe përveç Shefijes, kishin marrë pjesë edhe dy gra të familjes së saj. Jani ishte punuar nga Shefija për vajzën e saj Selvijën, kur kjo e fundit ishte në moshën 8-vjeçare. Foto.6. Kur Selviya ishte martuar në vitin 1976, ka marrë me vete edhe janin<sup>29</sup>. Jani ishte punuar në vek, në kuadër të ekonomisë shtëpiake. Materiali – leshi i janit ishte siguruar nga familja, pasi familja ishte marrë me blegtori, ndërsa fijet ishin ngjyrosur në Preshevë. Madhësia e janit: gjatësia 3.95m ndërsa gjerësia 1.26m. Pesha e janit mendohet që është rreth 14kg. Jani është i ndarë në pesë pjesë, në bazë të ngjyrave dhe të motiveve. Ngjyrat e përdorura janë: e kuqe, e gjelbër, e zezë, e verdhë dhe e bardhë. Motivet florale(bimore) janë aplikuar më shumë, por edhe motivet gjeometrike. Në të dyja skajet janë përdorur më shumë ngjyrat, si: e verdha, gjelbra, e bardha dhe më pak e kuqja, si dhe motivet gjeometrike me vija. Ngjitur me skajet është pjesa e dytë që përshkon pothuajse gjithë janin, ku janë përdorur ngjyrat: e bardha, e gjelbra, e kuqja dhe e zeza, si dhe motive me madhësi të mëdha (te quajtura lata) dhe forma të ndryshme. Në pjesën kryesore të janit dominon ngjyra e kuqe kombinuar me të gjelbrën. Janë të punuara katër lule (të quajtura këmbët e Arushës) me ngjyra të kombinuara: e bardha, e verdha, e kuqja dhe e zeza. Disa cukla të vendosura në pjesën kryesore të janit, janë bërë nga Hasibe Reshiti, si shenjë e kujtimit dhe që ka qenë prezente gjatë punimit të saj<sup>30</sup>. Jani tashmë është bërë pjesë e ekspozitës dhe është vendosur në minderin e dhomës së grave në shtëpinë e shek. XVIII, dhe do të vazhdojë tregimin bashkë me

<sup>27</sup> Selviye Sylejmani lindur në fshatin Vaksincë të Kumanovës më datën 14.2.1948 është martuar me Nexhat Sylejmani nga fshati Tërnavë të Preshevës. Kanë jetuar deri në vitin 1980 në Tërnavë, ndërsa nga viti 1980 jetojnë në Prishtinë.

<sup>28</sup> Shefije Abazi-Ramadani ka lindur në vitin 1.8.1911 në Izvor-Burim dhe ka vdekur në vitin 1992 në fshatin Vaksincë të Kumanovës.

<sup>29</sup> Nga intervista me Selviye Sylejmanin, mars, 2021 Prishtinë.

<sup>30</sup> Nga intervista me Selviye Sylejmanin, mars, 2021 Prishtinë

eksponatet e tjera të muzeut, gjithnjë duke i shërbyer shoqërisë dhe brezave të ardhshëm.



Foto 5. Selvije Sylejmani, ulur në janin e dhuruar, në dhomën e shtëpisë së miqve të shek. XVIII, në “Muzeun Etnologjik të Kosovës”.



Foto 6. Shefije Abazi-Ramadani me vajzën e saj Selvije Sylejmanin në fshatin Vaksincë të Kumanovës, Maqedoni e Veriut. Foto e realizuar më 20.10.1983.

### **Djepi, kusia dhe gjergjefi**

Të tria eksponatet - djepi, kusia dhe gjergjefi - i janë dhuruara vullnetarisht “Muzeun Etnologjik të Kosovës” nga Agim Malazogu, në ko-

rrik të vitit 2022.<sup>31</sup> Foto 7. Ato ishin përdorur nga nëna e tij, Myzaqete Malazogu, e cila jeton në Prishtinë dhe është 92-vjeçare.<sup>32</sup> Djep i bukur nga druri, i punuar në vitin 1952 (me gjasë në Gjakovë<sup>33</sup>) dhe i dekoruar me shije dhe mjeshtëri të hollë ka shërbyer për përkundjen dhe vënien e fëmijëve në gjumë. Djepi është i dekoruar me motive gjeometrike, me yllin gjashtëcepësh në pjesën qendrore, ndërsa pothuajse në gjithë sipërfaqen e jashtme dhe në pjesën e brendshme harkore është i zbukuruar me motive florale duke përdorur ngjyrat: të gjelbrën, të kuqen, të bardhën, të verdhën e të tjera. Kusi (enë metali) dhe saxhak (për të vënë enët e metalit mbi zjarr), për larjen e rrobave me hi, mbi 70-vjeçar i vjetër. Sipas Myzaqetes, në të kaluarën kusia në mbrëmje është mbushur me ujë dhe me hi, është vluar pak uji dhe ka qëndruar tërë natën me qëllim që, të nesërmen, të kullohet uji dhe pastaj janë zier dhe janë larë rrobat me të. Ajo, po ashtu, tregon se sapuni është përgatitur duke e përdorur dhjamin e bagëtive dhe sodën pluhur, të cilët janë vënë në kusi dhe janë lënë të qëndrojnë tërë natën. Të nesërmen, është bërë sapuni duke e ndarë në disa pjesë, e kanë vënë në diell për t'u tharë.<sup>34</sup> Kusia mbi saxhak është vendosur në dhomën e zjarrit afër oxhakut, në shtëpinë e miqve të shek. XVIII, duke u bërë pjesë e ekspozitës etnologjike të muzeut. Gjergjef disapjesësh nga druri, për punimin e tekstileve, jelekëve nga ari e mënda-fshi, brenda ekonomisë shtëpiake. Rreth 15 vjet ka punuar me të Myzaqete Malazogu. Foto 8.

<sup>31</sup> Nga intervista me Agim Malazogun, 17 korrik 2022, Prishtinë.

<sup>32</sup> Myzaqete (Stavileci) Malazogu nga Gjakova ishte martuar me Haki Malazogu (me profesion rrobaqepës) në vitin 1950, ndërsa deri në vitin 1960 kanë jetuar në Prizren, për t'u shpërngulur po të njëjtin vit në Prishtinë. Kishin tre femijë: Arsimi, Vjollca, Agimi.

<sup>33</sup> Gjakova ka qenë një nga qendrat kryesore të zejtarisë në Kosovë, ku edhe sot familja Qarri (drugdhendës) merret me punimin dhe prodhimin e enëve dhe orendive nga druri, përfshirë djepa të dekoruar dhe ngjyrosur me shumë shije.

<sup>34</sup> Intervistën me Myzaqete Malazogun e ka realizuar djali i saj, Agim Malazogu në shtëpinë e tyre, në korrik 2022, Prishtinë.



Foto 7. Agim Malazogu me eksponatet në oborrin e “Muzeut Etnologjik”.



Foto 8. Myzaqete Malazogu gjatë punës me tekstile në periudhën ndërmjet viteve 1953-1955.

### Arka e mbushur me eksponate

Një tjetër entuziast dhe dashamirës i etnokulturës shqiptare, Ajet Kida i ka dhuruar “Muzeun Etnologjik të Kosovës”, njëmbëdhjetë eksponate të familjes së tij në gusht të vitit 2022<sup>35</sup>. Ajeti me origjinë nga fshati Cermjan (krahina e Dushkajës), komuna e Gjakovës, i ka ruajtur me fanatizëm eksponatet në këto 20 vitet e fundit, duke u shprehur në intervistë, kur i shoh eksponatet, kujtoj kohën, historinë, fshatin, prejardhjen, familjen, tregimet, mënyrën e jetesës. Foto. 9. Eksponatet kanë qenë pjesë e enëve dhe orendive të kullës së vjetër të gurit, të familjes Kida, kullë e cila është shkatërruar në vitin 2003 në mungesë të restaurimit dhe konservimit<sup>36</sup>. Ato fillimisht ishin përdorur në kullë nga gjyshërit e Ajetit, Begë dhe Libade Kida, rreth 140 vite më parë, për t’u trashëguar brez pas brezi, e për të përfunduar këtë vit në koleksionet e muzeut<sup>37</sup>. Këto janë eksponatet: Arkë e nuses, në gjendje shumë të mirë, e punuar dhe zbukuruar me majë brisku në gjithë sipërfaqen e pjesës qendrore të saj, me motive kryesisht gjeometrike dhe aty këtu florale, sikurse vijat, katrorët e vegjël, trekëndësha dhe forma të tjera të kombinuara mes vete, si dhe bimë në formë të pemës së jetës. Në pjesën e sipërme të anës qendrore, në të dyja anët janë punuar 2 motive me 4 rrathë, ndërsa brenda tyre janë zbukuruar në formë të rrezeve të diellit apo të luleve 12-pjesëshe. Po ashtu, në pjesën e poshtme të anës qendrore janë punuar 2 motive me 3 rrathë, ku brenda janë zbukuruar në formë të rrezeve të diellit apo luleve 8-pjesëshe. Arka qëndron në katër këmbë të drurit, ku dy këmbët e para janë të zbukuruar me motive gjeometrike, ndërsa pjesët e poshtme me motivin e formës së pemës së jetës. Edhe një pjesë e pjesës së sipërme apo e kapakut të arkës është zbukuruar me motive gjeometrike<sup>38</sup>. Foto

<sup>35</sup> Eksponatet janë pranuar nga etnologët e muzeut në banesën e Ajet Kidës në Gjakovë, ku është realizuar edhe intervista më 26 gusht 2022. Ajet Kida, që nga viti 1998 jeton në Holandë.

<sup>36</sup> Nga intervista me Ajet Kida, 26 gusht 2022, Gjakovë.

<sup>37</sup> Nga intervista me Ajet Kida, 26 gusht, 2022, Gjakovë. Gjyshërit e Ajet Kidës: Begë Kida (gjyshi) vdekur në vitin 1962 dhe Libade Kida (gjyshja) vdekur në vitin 1967, çifti kishte 5 fëmijë: 3 vajza dhe 2 djem. Eksponatet janë trashëguar nga prindërit e Ajet Kidës në kullë, Avdyllah dhe Hava Kida, të cilët kishin 7 fëmijë, 5 djem dhe 2 vajza.

<sup>38</sup> Më shumë rreth drugdhendjes, shih punimin e Mark Krasniqit, ‘Gdhendja artistike e drurit në fshatrat e Kosovës’, Gjurmë e Gjurmime, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1979, (f. 443 -474).

10. Familja Kida kishte mundësi ekonomike ta porosisë arkën e pajës për nusen, e cila është e vjetër rreth 140 vjet. Eksponat mjaft interesant dhe me vlerë ishte dhe ora e murit e shek. XIX, e kohës së Austro-Hungarisë, e blerë për të qenë pjesë e orendive të kullës së familjes Kida. Eksponatet e tjera: matës kohe me diell nga druri (fetvah), kallëp druri për përpunimin e opingave, enë druri dhe dheu që janë përdorur për qumësht dhe ushqime të tjera, tabak dhe ftohës kafe nga druri, pastaj dy shtiza druri dhe pjesë druri të djepit të dekoruara me motive florale.



Foto 9. Ajet Kida me arkën e mbushur me eksponate.



Foto 10. Arti i aplikuar në arkë përmes motiveve gjeometrike.

## Qilimi

Ndër eksponatet më të veçanta të pranuar këtë vit nga “Muzeun Etnologjik i Kosovës” ishte edhe qilim i bukur i familjes së Zamire Kadës nga Prishtina, mbi 140 vjet i vjetër. Foto 11. Qilimi është dhuruar për të qenë pjesë e fondit të muzeut dhe i njëjti ka një rrëfim shumë interesant që lidhet me historinë e familjes dhe rrugëtimin e vështirë të mbijetesës deri më sot. Qilimi ishte punuar në Plavë të Malit të Zi në shek. XIX dhe i ka takuar fillimisht stërgjyshes së Zamires, Gjylë Medunjanin-Mekulit, nga Plava<sup>39</sup>, e cila pas një kohe ia kishte dhuruar vajzës së saj, Sheqere Kada-Mekulit, kur ishte martuar në Pejë. Sipas të dhënave nga familja, Sheqerja ka lindur para diku 112-115 vjetëve, ndërsa ka vdekur në vitin 1996. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, shtëpia e familjes Kada në Pejë ishte djegur, por kishte shpëtuar qilimi, i cili trashëgohet nga Mahir Kada dhe Zekie Kada, prindërit e Zamires. Familja Kada, në fund të vitit 1963, nga Peja shpërngulet në Prishtinë dhe marrin me vete qilimin, dhe, pas plot 59 vjetëve të kujdesjes dhe ruajtjes, i dorëzohet muzeut bashkë me tregimin e familjes.<sup>40</sup> Qilimi, përveç që është i bukur dhe i ruajtur, është i veçantë dhe i rrallë për shkak se është një-pollësh - nga një pjesë (dimensionet 2:80m –3:60m) dhe i punuar në vek vertikal. Në bazë të ngjyrave dhe tëmotiveve, ka tiparet e qilimit të Kosovës, ashtu siç njihet në kulturën shqiptare një qilim i tillë<sup>41</sup>. Shquhet për kromatikën e pasur me ngjyrat e ndezura, ku në hapësirën më të madhe të tij dominon ngjyra e kuqe sidomos në pjesën qendrore, e kombinuar me ngjyrën e zezë dhe të bardhë në anësoret dhe pjesët e tjera. Ngjyrat e përdorura në qilim janë të shumëllojshme dhe ngjajnë me ylberin, që përveç ngjyrave të lartpërmendura, kanë gjetur përdorim dhe ngjyrat: e verdha, e kaltra, e kafenjta, e portokallta, e gjelbra e të tjera. Vihet në pah

<sup>39</sup> Gjylë Medunjanin Mekuli nga Plava ka qenë e martuar me Hoxhë Nokshiqin (i shkolluar në Turqi dhe njohës i 8 gjuhëve), përndryshe prindërit e akademikut të njohur shqiptar Esad Mekulit. Sipas të dhënave të marra nga familja, Sheqere Kada-Mekuli ka lindur para diku 112-115 vjetëve, ndërsa ka vdekur në vitin 1996. Ishte e martuar me Rexhep Kadën, i cili ka vdekur në vitin 1957. Qilimi trashëgohet nga Mahir Kada (15.12.1934 - 12.05.2019) dhe Zekie Kada (25.05.1934 - 29.12.2015), prindërit e Zamires. Zamire Kada ia dorëzon qilimin muzeut duke e konsideruar si vendin e duhur për të ruajtur dhe për ta ekspozuar.

<sup>40</sup> Intervista me Zamire Kadën, 4.10.2022, Prishtinë.

<sup>41</sup> Ikbali Bihiku, *Arti popullorë shqiptar-punime leshi në vegje* (Tiranë: Akademia e Shkencave të RPSH, Instituti i Historisë, Sektori i Etnografisë, 1977), f. 43.

po ashtu, ornamentika dhe kompozicioni i motiveve<sup>42</sup>. Motivet e qilimit, në tërë sipërfaqen e tij, janë kryesisht gjeometrike, në forma dhe madhësi të ndryshme. Qilimi është i ndarë në katër pjesë sa i përket përdorimit të ngjyrave dhe motiveve. Në skaje është përdorur ngjyra e kuqe, e dekoruar me ngjyrën e zezë, e ngjashme në stil, sikurse motivi i shqiponjës. Ngjitur me skajet është pjesa e dytë që përshkon qilimin, ku dominon në masë të madhe ngjyra e bardhë, e në të janë të aplikuara motivet (gjeometrike në madhësi dhe forma të llojeve të ndryshme) dhe ngjyrat e kombinuara sikurse: e gjelbra, e kuqja, e zeza, e verdha, portokalli, e kaltra, e kafenjta e të tjera. Pjesa e tretë e qilimit, skajet i ka me ngjyrë të zezë me pika të bardha, si dhe me trekëndësha të kuq. Kjo pjesë e qilimit është më e ngushtë se e dyta, me motive gjeometrike, të punuara në formë të katrorëve me ngjyra të ndezura, që përshkojnë herë në anën e majtë e herë në të djathtë. Pjesa qendrore e qilimit është e ngjyrosur me ngjyrën e kuqe, e dekoruar me motivin e rombit në gjithë sipërfaqen e saj, me ngjyrën e zezë të kombinuar me të verdhën dhe të bardhën. Foto 12.



Foto 11. Zamire Kada me qilimin e familjes.

<sup>42</sup> Më shumë rreth artit popullor në tekstile, shih edhe librin e Andromaqi Gjergjit, *Arti i zbatuar popullor* (Tiranë: Liar, 2006).




Foto.12. Harmonia e ngjyrave dhe kompozicioni i motiveve në qilimin njëpollësh.

### Përfundim

“Muzeu i Kosovës”, si institucioni i parë dhe më i lartë muzeal i themeluar në Kosovë, gjatë veprimtarisë së tij mbi 70-vjeçare, përkundër sfidave të kaluara, ka arritur të japë kontributin në fushën e kulturës, qoftë në hulumtimin, zbulimin, mbledhjen, ruajtjen dhe mbulimin e hapësirës kosovare me ekspozate dhe objekte prezentative dhe në studimin, prezantimin, promovimin dhe ekspozimin e trashëgimisë së nëndheshme dhe të mbidheshme të Kosovës. Lënda muzeale e mbledhur nga personeli profesional i “Muzeut të Kosovës”, që i takon periudhave të ndryshme historike, pastaj përbërja e ndryshme lëndore dhe fushat kulturore (arkeologjike, etnologjike, historike) janë dëshmi e thesarit dhe trashëgimisë së pasur kulturore të Kosovës.

Vitet e fundit, etnologët e “Muzeut Etnologjik të Kosovës”, krahas punës në muze, janë marrë me pasurimin e fondit muzeal, kryesisht përmes pranimit të ekspozateve të dhuruara nga qytetarët. Rëndësi u është kushtuar pjesës së historisë gojore, kujtesës dhe trashëgimisë familjare, si dhe vlerave kulturore, artistike, shpirtërore të ekspozateve të pranuar në

muze. Ekspонатet e dhuruara, përveç vjetërsisë dhe vlerave etnokulturore, shquhen edhe për aftësitë krijuese të mjeshtërve dhe të grave, në kuadër të artizanateve shtëpiake, artit popullor, përdorimit të teknikave, motiveve dhe simboleve, pastaj kromatikës dhe kombinimit të ngjyrave.

## **EXHIBITS AND THE MUSEUM – RICHNESS, HISTORY, HERITAGE**

### **Summary**

This paper will deal with a small part of the history and contribution of the Museum of Kosovo, as well as collecting of the museum collection in the field of ethnology and enrichment with new exhibits. The Museum of Kosovo, despite difficulties, circumstances and challenges faced during its activity since its establishment in 1949, has managed to give a lot to the field of culture. Thus starting with the first authentic research in Kosovo in the field of archaeology, then ethnology, nature, history and related fields. It has managed to discover the archaeological treasure and dozens of archaeological sites throughout Kosovo. A large number of archaeological, ethnological, historical, natural, and numismatic exhibits, followed by documents, photographs, have been collected and brought to the museum by its staff, thereby establishing the first collections, which are already numerous, covering different periods and fields. New cultural institutions have been established within the Museum of Kosovo. The ethnology fund comprising several thousand exhibits, which mainly cover the period of the XVIII-XX centuries, and which can be classified according to different historical periods, subject composition, ethnocultural backgrounds and different of social, economic and social structures. The focus of this paper will be on the part of oral history, memory, family heritage as well as the cultural, artistic and spiritual values of the exhibits collected and donated by citizens during the recent years. There are a total of six conversations of different subjects, as described according to the exhibits, which they donated. As challenges remain, the destruction of hundreds of thousands of objects and family houses along with exhibits, during the last war in Kosovo, the lack of research-collecting activities and the non-allocation of the budget for purposes of

buying of private collections. Also rapid economic, social and technological developments and way of life in modern times makes families stop using their old things inherited from their ancestors.

### **Bibliografia:**

- Gjergji, Andromaqi, *Arti i zbatur popullor* (Tiranë: Liar, 2006).
- Krasniqi, Mark, 'Gdhendja artistike e drurit në fshatrat e Kosovës', në *Gjurmë e Gjurmime* (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1979).
- Kozarac, Vasilije, *Glasnik Muzeja Kosova - Buletini i Muzeu të Kosovës I*, (Prishtinë: 1956).
- Malcolm, Noel, *Kosova një histori e shkurtër* (Prishtinë: Koha, 2011).
- Morina, Tefik, Rruga e zhvillimit dhe perspektiva e muzeve në Kosovë, *Buletini i Muzeut të Kosovës XII*, (Prishtinë: 1974).
- Statovci, Drita, 'Portreti i një veterani të shkencës shqiptare', Kadri Halimi, *Trajtime dhe studime etnologjike* (Prishtinë: IAP, 2000).
- Shkodra, Valon, *Muzeu Etnologjik i Prishtinës dhe funksioni i tij* (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2019).
- Xhemili, Bekim, 'Mbulimi i hapësirës kosovare me objekte prezentative muzeale', *Albanologi 4* (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2014).
- Bihiku, Ikbali, *Arti popullorë shqiptar-punime leshi në vegje* (Tiranë: Akademia e Shkencave të RPSH, Instituti i Historisë, Sektori i Etnografisë, 1977).
- Të dhëna nga Muzeu i Kosovës, prill 2011.
- Intervista me Kemajl Lucin, arkeolog në Muzeun e Kosovës, prill 2011, Prishtinë.
- Intervista me Mehmet Gjoshi, historian në Muzeun e Kosovës, mars, 2011, Prishtinë.
- Intervista me Ramadan Ibrahimin, punonjës i Institutit Albanologjik të Prishtinës, maj 2011.
- Intervista me Dr.Riza Sadiku, historian në Muzeun e Kosovës, prill, 2011, Prishtinë.

Intervistat me shefin e sektorit të etnologjisë në Muzeun e Kosovës, Mumin Zeqirin, mars 2011, Prishtinë.

Intervista me Petrit Riza, qershor, 2020, Prishtinë.

Intervista me Sokol Shasivarin, qershor, 2020, Prishtinë.

Intervista me Nezafete Karaxha-Çitaku, nëntor, 2020, Prishtinë.

Intervista me Selvije Sylejmanin, mars, 2021, Prishtinë.

Nga intervista me Agim Malazogun, korrik 2022, Prishtinë.

Intervistën me Myzaqete Malazogun e ka realizuar djali i saj, Agim Malazogu, në shtëpinë e tyre, në korrik 2022, Prishtinë.

Intervista me Ajet Kida, gusht, 2022, Gjakovë.

Intervista me Zamire Kada, tetor, 2022, Prishtinë.

### **Fotografitë:**

Fotot: (1,2,3,4,5,7,9,10,11,12) Bekim Xhemili.

Foto (6) Arkivi familjar i Selvije Sylejmanit.

Foto (8) Arkivi familjar i Agim Malazogut.



# **KRITIKA DHE RECENSIONE**

